

Aktualitet

Si u kthye gjakmarrja në biznesin e gjakut

Te identifikosh e te trajtosh ngjarjet bazuar ne statistika te sakta ndoshta do te ishte detyra e pare e nje shoqate qe merret me fenomenin e gjakmarrjes, por gjithcka pikerisht ketu fillon e veshtiresohet. Ne maj te ketij viti Drejtoria e Policise se Qarkut Kukës jepte vetem per rrethin e Tropojes 10 familje te ngujuara, ne e nejeten kohe ne nje gazete lokale shifra e familjeve qe jetojne te ngujuara ne Tropoje arrinte ne 290 familje. "Kulla e ngujimit, vendi ku fajtori pret qe dikush do te ndermjetesoje, qe faji te gjykohet me drejtesi" thuhet ne nje kartoline sensibilizimi financiar nga qeveria hollandeze. Eshte viti 2008.

Nëpër labirintet e gjakmarrjes

Personazhi i noveles "Gjaku" te Ernest Koliqit, eshte nje i ri i diplomuar ne Perendim. I gjendur nen presionin e njerezve qe e rrethojne eshte i detyruar te mare gjakun e te vellait. Pas kesaj dorëzohet duke fajësuar shoqerine, autoritetet qe do te kishin mundur ta ndalonin, nese ata do te zbatonin ligjin. Ngjarjet zhvillohen ne Shkoder. Esh-te viti 1928.

Ushtria e njerezve te gjakmarrjes mret bazuar

te gjaqeve e hasmerive. Te reja e te vjetra. Privatishet apo ne nivel lokal veprojne edhe misionar te veteshpallur te cilet interpretojne gjithcka sipas zones, zakoneve lokale e vecorive te konfliktit. Ne rrethin e Lezhes nje mjek ishte i detyruar te paguante nje shume te konsiderushme parash per mbylljen e nje konfliktit te nisur thelle ne kohe nga xhaxhai i babait te tij. Vete ai ishte per kater vjet pjestar i misionit lokal te Pajtitimit. "Parashikohet ne Kanun, thote nje ekspert pajtimesh, qe familja e demtuar te jape faljen kundrejt nje pagese ne para apo prone". Por ajo qe ndodh jo ne pak raste

im te drejte nga shteti" lexohet ne dokumente te komitetit. "Pa dyshim qe nje pjese e madhe e vendimeve te gjykateve te cojne ne vazhdimin e konfliktit" thote Marku. Vetem pak dite me pare pas vendimit te gjykates se shkalles se pare, per nje vrasje te dyfishte, te kryer me 24 dhjetor te vitit te kaluar ne Velipoje, A. Zefi u denua me 25 vjet burgim. "E meritonte burg perjete. Do bejme vetegjygesit" do te shpreheshin te afermit e viktimave.

40 milionë USD financime të humbura

Per tu kthyer edhe nje here tek fondet, ne fundin e 2005 vete Komiteti i Pajtitimit me ane te nje deklarate do te kerkonte qe te saktesohej e te verifikohet se ku kishte perfunduar shumja prej 40 milion USD kontribut i komunitetit nderkombetar per projektet e rehabilitimit te familjeve te perfshira ne gjakmarrje. E ndersa kerkohej destinacioni i fondeve, pikerisht ne ditet kur misionaret ne pranvere-veren e nxehte politike te 2005, ndermerrnin nje ekspedite mbarekombetare, nuk do te mund te ndalonin vrasjet e 3 majit ne fshatin Dukagjin, Mat ku u qelluan ne prite tre femije, duke mbetur i vrare me i madhi A. Nuka si dhe vrasjen e trefishte po per gjakmarrje me 18 qershor, ne fshatin Ishem, Durres. Tre pjestare te familjes Gjokeqaj. Njeri ishte vetem 13 vjec.

Ne kete ekspedite u mund te konstatohej vetem qe "hasmerite me te thella jane ato qe lindin e trashegohen per shkaqe vrasjeje". Vetem kaq

uar nje gje te tille. Kjo sidomos ne ato raste kur konflikti apo hasmeria me sfond kanunor, jane nje arsye baze per perfitimin e azilit ne nje ne nje vend perendimor. Nuk jane te rradha edhe rastet kur sajimi e nje pseudokonfliktit ka edhe "bekimin" e medias. Kjo kundrejt pageses perkatese. Ne nje rast i jepet statusi i personit ne konflikt M.S., i cili eshte i detyruar te lere vendin. Pasojat i vuan, gjithmone sipas materialeve te dosjes, edhe vellai e familja e tij.

Ne te vertete ngjarja e ka zanafillen ne fundin e vitit te kaluar kur ne nje zenie banale kafeneje, S.M. plagos me thike nje nga personat qe po e keqtrajtonin. Pas arratises se S.M. duket se pasojat i vuan i vellai dhe pjestare te tjere te familjes. Duke folur per kete rast nje organ i medias e perkshruan si nje rast tipik te zbatimit te rregullave kanunore. "Familja T. ia kerkon gjakun ne baze te kodit mesjetar te Lek Dukagjinit, pjestareve te tjere te families S. Pra qe nga dita e plagosjes dy familjet mund te konsiderohen ne gjak" shkruhet ne kroniken e ngjarjes. Me tej si per ti dhene nje vule edhe me pashprese gjithë "konfliktit" artikulli nenvizon faktin qe policia e shoqatat e pajtitimit e kane te pamundur te "nderhyjne ne kete konflikt te madh".

"Per cdo rast ne kemi dosjet tona" shprehet kryetari Komitetit te Pajtitimit si dhe nje "shkembim te vazhdueshem informacioni me mjaft polici te vendeve perendimore, per raste te vecanta qe ata kerkojne te verifikojne". Ne nje dosje tjetër flitet per nje konflikt me sfond sentimental ku dy te rinj nga zona e nen Shko-